

**“ ROLI I QENDRAVE KORREKTUESE NË REHABILITIMIN  
DHE RISOCIALIZIMIN E TË BURGOSURVE (Rasti i Lipjanit)”**

**TEMA PËR TITULLIN  
MASTER I SOCIOLOGJISË  
NGA**

**ALBAN GASHI**



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**

**FAKULTETI FILOZOFIK  
DEPARTAMENTI I SOCIOLOGJISË**

**PRISHTINË**

**MAJ, 2021**

## **REZYME**

### **“ ROLI I QENDRAVE KORREKTUESE NË REHABILITIMIN DHE RISOCIALIZIMIN E TË BURGOSURVE ”**

**(Rasti i Lipjanit)**

#### **Mentori:**

Prof. Ass. Dr: FADIL MALOKU

Thelbi kryesor i këtij punimi është hulumtimi i procesit të rehabilitimit, ndjeshmërisë dhe trajtimit të të burgosurve, se si ndihen dhe si trajtohen ata gjatë kohës që ata janë të privuar nga liria. Qendrat korrektuese janë institucione të mbyllura, gjysmë të hapura dhe të hapura por ato janë së pari institucione shtetërore të sigurisë dhe në këtë këndvështrim i shërbejnë shoqërisë për ta mbrojtur por edhe për t'i rikthyer asaj individë më të përgjegjshëm pasi ata kanë kryer dënimin e tyre. Për të përmbushur këtë mision, nga njëra anë, jeta në burg duhet rregulluar e tillë që të jetë sa më pranë jetës normale, në kushtet ku individëve u respektohen të drejtat e tyre të garantuara në ligj dhe nga ana tjetër, sistemi i burgjeve duhet të ketë një mënyrë efektive të dhënies së llogarisë lidhur me sa dhe si respektohen të drejtat e personave që ka nën kujdes tek organet e ndryshme shtetërore dhe jo-shtetërore. Në bazë të këtij hulumtimi për qendrat korrektuese por edhe në bazë të hulumtimit të literaturës përkatëse në gjuhën shqipe kemi vërejtur se mungojnë studimet dhe hulumtimet konkrete në këtë segment i cili nuk e meriton assesit të mbetet nën hije dhe pa trajtim të mirëfilltë.

## **Për nga struktura, e kam ndarë punimin në pesë pjesë apo kapituj.**

Në strukturën e punimit kam paraqitur pjesën hyrëse dhe historikun e qendrave korrektuese në Kosovë. Punimi në strukturën e tij përmban gjithashtu edhe pesë kapituj, duke përfshirë këtu rezultatet e hulumtimit, përfundimin dhe rekomandimet. Në këtë hulumtim janë përdorur të dhëna prej burimeve primare dhe sekondare poashtu informacionet gjegjësisht të dhënat janë të siguruar nga anketat që kanë qenë bazë për përgatitjen e këtij punimi. Pra përveç intervistave dhe anketave që janë realizuar, janë përdorur edhe metoda të analizës së përmbajtjes dhe metoda të tjera. Prej instrumenteve të metodologjisë së hulumtimit është përdorur metoda e intervistimit dhe anketimit dhe kjo metodë e intervistimit më shumë është e bazuar në pyetësorë me pyetje të tipit të mbyllur dhe të hapur, pyetjet me shkallën e Likërit, shkallët e radhitjes- rangimi si edhe shkallën e Bogradusit. Dhe në fund është bërë analiza dhe vërtetimi i hipotezave dhe janë realizuar me programin e statistikave SPSS.

**Kapitulli i parë: Modeli i qendrave korrektuese dhe rehabilitimi.** Në këtë kapitull kam paraqitur sistemin e qendrave korrektuese dhe funksionimin e tyre në Kosovë dhe të drejtat e të dënuarve në qendrat rehabilituese. Shërbimi Korrektues i Kosovës sipas funksionit që luan ka qendrat e paraburgimit, burgun e sigurisë së lartë si dhe qendrat korrektuese. Është me rëndësi që të bëhet një dallim terminologjik në mes të qendrave korrektuese dhe burgut. Përderisa sistemi korrektues është tërsia e institucioneve të cilat i mbajnë të privuarit nga liria, burgu është nënsistem i qendrës korrektuese e cila zakonisht ka persona të cilët janë të dënuar me kohe më të gjatë të heqjes së lirisë dhe zakonisht mban persona me rrezikshmëri të lartë. Përmes kësaj pjese kam përmendur se të burgosurit duhet të gëzojnë të drejta të cilat janë të mëshiruara si në dokumente e ligje kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare dhe kanë karakter të detyrueshëm.

**Në kapitullin e dytë: “Rehabilitimi”.** Në këtë kapitull kam sqaruar kushtet elementare higjienike, ushqimore dhe shëndetësore poashtu dhe llojet e risocializimit në qendrat korrektuese. Kam ardhur në përfundim se me disa përjashtime të vogla aspekti higjienik dhe ushqimi janë në nivelin e duhur kjo për faktin se edhe në vlerësimet e të burgosurve në përgjithësi janë raportuar aspekte pozitive dhe të qëndrueshme të këtyre dy aspekteve. Gjithashtu edhe shëndetësia në qendrat korrektuese dhe rehabilituese në burgje sipas të dhënave që QKRMT që i kam siguruar nga DSHB (departamenti shëndetësor i burgjeve) del se në krahasim me higjienën dhe ushqimin çështja e shëndetësisë në burgje është larg standardeve të kërkuara dhe të pranueshme për burgjet. Kandidati ka përmendur edhe risocializimin i cili synon që sjelljet devijante të të burgosurve ti sjellë me afër me sjelljet të gjithë individëve të shoqërisë të cilat konsiderohen si sjellje konformiste dhe konform me ligjin.

**Kapitulli i tretë “Metodologjia e hulumtimit”** Për realizimin e këtij hulumtimi është përdorur metoda hulumtuese sasiore ose kuantitative. Si procedure hulumtuese është përdorur anketimi i cili është realizuar në formën e pyetësorit i cili është aplikuar me personat në qendrën e korrektuese në Lipjan. Përpos metodës hulumtuese çështjet bazë të rolit të qendrave korrektuese në rehabilitimin dhe risocializimin e të burgosurve e kam analizuar edhe nga këndvështrimi teorik. Rezultatet e pyetësorit janë nxjerrë duke i kalkuluar pikët e marra nga përgjigjet e respondentëve, si dhe të dhënat janë analizuar përmes programit SPSS. Pjesëmarrës të këtij hulumtimi kanë qenë 60 të burgosur në qendrën korrektuese të Lipjanit, ku 9 prej tyre kanë qenë të gjinisë femërore dhe 51 të gjinisë mashkullore. Fillimisht është kërkuar leja me shkrim nga drejtorja e qendrës për realizimin e hulumtimit nëpër pavionet e burgut, pastaj kemi shkuar në qendër dhe e kemi bërë realizimin e pyetësorëve dhe kemi vendosur që të përdorim mostër grupore.

**Kapitulli i katërt trajton “Rezultatet e hulumtimit”** Në këtë kapitull i kam prezentuar rezultatet në grafikone dhe tabela dhe i kam komentuar këto rezultate të cilat janë nxjerrë nga programi SPSS.

### **Në kapitullin e pestë: “Të gjeturat e hulumtimit”.**

Përmes analizës statistikore i kam paraqitur të dhënat nga 60 respondentë të cilët me vullnet të plotë pranuan ti nënshtrohen anketimit në qendrën rehabilituese-korrektuese në Lipjan.

Sa i përket moshës kryesisht kanë qenë të moshave të ndryshme duke filluar nga mosha 16 vjeçare pasi që kjo qendër është edhe qendër rehabilituese për të mitur dhe femra e deri tek mosha 63 vjeçare. Qëllimi i punimit ishte dhe është i qartë, hedhja drite mbi rolin dhe rëndësinë e qendrave korrektuese në rehabilitimin dhe risocializimin e të burgosurve në Kosovë me theks të veçantë Qendra Korrektuese e Lipjanit. Në fund kam nxjerrë disa rekomandime të cilat i’u adresohen institucioneve përgjegjëse për financimin dhe mbikëqyrjen e shërbimit korrektues si dhe qendrave korrektuese në veçanti.